

Nr. 1874/Prot.

Tiranë, më 08/04/2024

Lënda: **Mbi çmimin e energjisë elektrike për kategorinë e klientëve furrë buke dhe prodhim mielli.**

Drejtuar: **Znj. Erjola SADUSHI**  
**Kryetare në detyrë**  
**Enti Rregullator i Energjisë**

Për dijëni: **Z. Enea KARAKAÇI** ✓  
**Administrator**  
**“Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group” SH.A.**

*E nderuar znj. Sadushi,*

Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr.793/2 Prot, të datë 05.04.2024 me lëndë “Kërkesë për informacion” shprehemi se:

Propozimi i “FSHU” SH.A. lidhur me ndryshimet në çmimet e klientëve të kategorizuar në segmentin “Furra buke dhe prodhim mielli” shprehur në shkresën Nr.1583 Prot, dt.19.03.2024 me lëndë “Mbi çmimin e energjisë elektrike për kategorinë e klientëve furrë buke dhe prodhim mielli” u mbështet paraprakisht edhe në një analizë faktoriale statistikore dhe financiare, në përfundim të së cilës u verifikua se:

Ndryshimet e propozuara të çmimeve nuk do të sjellin shtesë apo pakësim të të ardhurave në performancën financiare të “FSHU” SH.A.

Vlera e shtuar në të ardhura nga ndryshimi në rritje i çmimeve (nga 7.6 Lekë/kWh në 9.5 dhe 12 Lekë/kWh) për një pjesë të klientëve aktualë në këtë kategori, pritet të jetë praktikisht e njëjtë me vlerën e pakësimit të të ardhurave nga klientët që kthehen në këtë kategori, nga kategoria “privatë” në tensionin 0,4 kV me çmimin aktual 14 Lekë/kWh.

**1. Nga analiza lidhur me efektet financiare të ndryshimit të çmimeve:**

a) *Të dhëna historike bazë mbi konsumin për kategorinë Furra Buke dhe Prodhim Mielli për periudhën 2017 - 2023 sipas raporteve të strukturës së shitjes paraqiten në tabelën që vijon:*

Viti	Aktive	Reaktive	Pik	Aktive + Pik
2017	78,537,360	3,803,725	1,091,115	79,628,475
2018	79,432,449	5,257,515	859,442	80,291,891
2019	82,815,818	4,364,375	1,442,013	84,257,830
2020	74,723,760	4,833,511	1,668,551	76,392,311
2021	82,013,959	4,653,354	1,602,486	83,616,445
2022	68,052,839	1,503,552	749,840	68,802,679

kWh

2023	69,001,671	1,943,462	1,217,039	70,218,710
------	------------	-----------	-----------	------------

Parashikimet për konsumin në këtë kategori në vitin 2024 bazuar në trendin historik 2023 të rritjes paraqiten në tabelën që vijon:

Përshkrimi	Njësia	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Parashikim 2024
<b>Parashikimii të ardhurave me Çmimin Aktual</b>									
Energji Aktive + Energji Pik	kwh	79,628,475	80,291,891	84,257,830	76,392,311	83,616,445	68,802,679	70,218,710	71,663,884
Çmimi Furrë Buke dhe Prodhim Mielli	Lekë	7.60	7.60	7.60	7.60	7.60	7.60	7.60	7.60
Trendi i rritjes /zvogëlimit të konsumit	%		↑ 1%	↑ 5%	↓ -10%	↑ 9%	↓ -18%	↑ 2.1%	↑ 2.1%
Te ardhura nga Shitja e Energjisë	Lekë	605,176,410	610,218,372	640,359,511	580,581,564	635,484,982	522,900,360	533,662,196	544,645,521

Sikurse vërehet në tabelë:

- Ndryshimet e pazakonta në trendin e konsumit në këtë kategori lidhen me masat për të saktësimin e klasifikimit të klientëve me kalime të shumta në kategorinë e klientëve privatë me çmim energjie prej 14 Lekë/kWh. Viti 2021 përkon me rritje të përgjithshme të konsumit pas periudhës së Covid 2019, e cila është përdorur si bazë në analizën e kryer.
- Trendi i rritjes së konsumit të energjisë për këtë kategori në vitin 2021 ishte 9%.
- Masat e marra për riklasifikimin e klientëve, vetëm në prodhim mielli dhe furra buke, kanë zvogëluar në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, me rreth 14,814 MWh sasinë e energjisë së shitur.
- Për të vlerësuar efektin e rritjes së çmimit për klientët gjatë 2024 u morën parasysh supozimet e mëposhtme: Sasia e energjisë do të vazhdojë të rritet me trendin e vlerësuar për vitin 2023 prej 2.1% (duke mos marrë parasysh klientët që do të rikategorizohen nga kategoria klientë privatë me çmim të shitjes së energjisë elektrike 14 Lekë/kWh).
- Çmimi mesatar i shitjes do të jetë 9.5 Lekë/kWh që përkon me propozimin për klientët në aktivitetin e furrave të bukës që shesin edhe prodhime brumi (pastiçeri)

Efekti në rritje të të ardhurave për shkak të rritjes së çmimit mesatar paraqitet në tabelën që vijon:

Përshkrimi	Njësia	Parashikim 2024
<b>Parashikimii të ardhurave me Çmimin Aktual</b>		
Energji Aktive + Energji Pik	kwh	71,663,884
Çmimi Furrë Buke dhe Prodhim Mielli	Lekë	7.60
Trendi i rritjes /zvogëlimit të konsumit	%	↑ 2.1%
Te ardhura nga Shitja e Energjisë	Lekë	544,645,521
<b>Parashikimi i të ardhurave 2024 me Çmimin mesatar të rritur</b>		
Energji Aktive + Energji Pik	kwh	71,663,884
Çmimi Mesatar Furrë Buke / Prodhim Mielli dhe aktivitete të lidhura	Lekë	9.50
Trendi i rritjes /zvogëlimit të konsumit	%	↑ 2.1%
Te ardhura me çmimin e ndryshuar (mesatar 9.5 Lekë/kwh)	Lekë	680,806,902
<b>Efekti i rritjes së çmimit në të Ardhurat</b>	Lekë	136,161,380

Bazuar në supozimet e mësipërme të ardhurat e shoqërisë për vitin 2024 pritet të rriten për rreth 136 milion Lekë.

b) Efekti i ndryshimit në ulje të të ardhurave nga klientët aktiviteti i të cilëve do të rivlerësohet, bazuar në kushtet e liçensimit dhe çmimeve të reja.

Ndryshimi në rritje i çmimeve të shitjes së energjisë për klientët e liçensuar në prodhime të bukës dhe miellit krahas aktiviteteve të tjera (pastiçeri, kafene etj) do të krijojë mundësinë e kthimit për shkak të kategorizimit të ri, të klientëve privatë që aktualisht blejnë energji me çmimin 14 Lekë/kWh. Kjo do të sjellë ulje të të ardhurave nga shitja e energjisë për FSHU SH.A.

Llogaritjet lidhur me uljen e të ardhurave në shitjen e energjisë për shkak të rikategorizimit të klientëve duke u bazuar në supozimet e mëposhtme:

- Rikthim të klientëve të cilët u përjashtuan më parë nga kategorizimi bazuar në uljen e konsumit për këtë kategori si diferencë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 prej 14,814 kWh.
- Shtesën e munguar të rritjes së konsumit për periudhën 2022 – 2023, me trendin e vitit 2021 krahasuar me vitin 2020 sipas formulës:

$$\text{Energji aktive dhe pik 2021} * \text{trendin e rritjes së konsumit} * 2 \text{ (për 2022/2023)}$$

- Diferencën e çmimit mesatar të shitjes së energjisë sipas propozimit prej 9.5 Lekë/kWh nga çmimi aktual prej 14 Lekë/kWh prej 4.5 Lekë/kWh

Përskrimi	Njësia	Parashikim 2024
Ulja e të Ardhurave për shkat të Kthimit të Klientëve nga çmimi 14 Lekë/kwh		
Ulja e Energjisë së shitur në vitin 2022 në krahasim me 2021 për shkak të shitjes së produkteve të tjera veç bukës	kwh	(14,813,766.00)
Shtesa e munguar e rritjes së konsumit 2024 - 2021 (me rritje 5% viti '21)	kwh	(15,444,318.61)
<b>Energjia nga klientët që pritet të kthehen nga çmimi 14 Lekë/kwh</b>	<b>kwh</b>	<b>(30,258,085)</b>
Diferenca e çmimit nga çmimi mesatar (14 - 9.5 Lekë/kwh)	Lekë	4.50
<b>Të ardhura të munguara nga shitja e Energjisë</b>	<b>Lekë</b>	<b>(136,161,381)</b>
<b>Të ardhura Neto (të shtuara) për vitin 2024</b>	<b>Lekë</b>	<b>- 0</b>

Si rezultat i rikthimit të klientëve në kategori me çmim më të ulët nga ai aktual shoqëria “FSHU” SH.A. pritet të ketë një ulje të të ardhurave prej rreth - 136 milion Lekë duke shuar efektin e rritjes së çmimeve në tabelën më sipër.

## 2. Pasqyrat e performancës për vitin 2023 dhe parashikimi për vitin 2024

Parashikimet për performancën (pasqyrat financiare në proces auditimi) për vitin 2023 tregojnë një fitim neto prej 19 milion Lekë dhe për vitin 2024, 107.5 milion Lekë:

FSHU PASH (000 / Lekë)	Parashikim 2023	Plan 2024
<b>TË ARDHURA</b>	<b>69,156,464</b>	<b>60,262,424</b>
<b>Të Ardhura Kryesore</b>	<b>69,112,391</b>	<b>59,813,593</b>
<b>Të Ardhura nga Shitja</b>	<b>69,112,391</b>	<b>59,813,593</b>
Konsumatorët Familjarë 04 kv	30,310,468	29,621,626
Konsumatorët Privatë 04 kv	15,496,816	15,144,632
Konsumatorët Buxhetorë 04 kv	2,209,604	2,159,388
Konsumatorët Jo Buxhetorë 04 kv	628,835	614,544
Klientë Privatë- 35Kv "FMF"	70,180	-
Klientë JoBuxhetorë - 35Kv "FMF"	178,757	163,299
Klientë Privatë - 20/10/6 Kv "FMF"	13,606,430	5,588,530
Klientë Buxhetorë -20/10/6 Kv,FMF	3,401,829	3,434,437
Klientë JoBuxhetorë -20/10/6 Kv,FMF	1,871,633	2,166,194
<i>Të Ardhura nga Kamatvonesa</i>	1,337,838	920,941
<b>Të Ardhura të Tjera</b>	<b>44,074</b>	<b>448,830.92</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>(68,599,586)</b>	<b>(59,656,292)</b>
<b>Shpenzime Energjie</b>	<b>(63,454,469)</b>	<b>(54,931,974)</b>
<i>Energjia e Blerë</i>	<i>(23,878,864)</i>	<i>(18,306,233)</i>
Blerje nga Tregu i Parregulluar	(127,185)	(0)
Blerje Lokale KESH	(23,751,679)	(18,306,233)
<i>Tarifa e mirëmbajtjes 0 kwh</i>	<i>(649,665)</i>	<i>(595,185)</i>
<i>Tarifa e Shpërndarjes</i>	<i>(32,973,754)</i>	<i>(30,779,761)</i>
<i>Energjia Reaktive</i>	<i>(490,656)</i>	<i>(154,609)</i>
<i>Tarifa e Transmetimit</i>	<i>(4,736,191)</i>	<i>(4,300,313)</i>
<i>Disbalancat</i>	<i>(725,338)</i>	<i>(795,874)</i>
<b>Marzhi Bruto</b>	<b>4,320,084</b>	<b>3,960,678</b>
<b>Marzhi Bruto në %</b>	<b>6.37%</b>	<b>6.73%</b>
<b>Shpenzimet Operative</b>	<b>(2,959,861)</b>	<b>(3,288,606)</b>
Lëndët e Para dhe të konsumueshme	(18,590)	(66,784)
Shpenzime për të Punësuarit	(951,324)	(1,137,849)
Mirëmbajtje	-	(35,197)
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	(296,864)	(133,878)
Shërbime Korporative	(439,116)	(443,745)
Marrdhënie me Publikun	(27,842)	(28,000)
Qera	(10,058)	(23,200)
Shërbime Postare	(835,058)	(945,203)
Shpenzime të IT	-	-
Shpenzime Ligjore	(1,532)	(1,050)
Konsulencë dhe Auditim	(37,584)	(23,000)
Të tjera	(341,893)	(450,700)
<b>Demtime dhe Provigjone</b>	<b>(2,033,237)</b>	<b>(1,252,615)</b>

<b>EBITDA</b>	<b>708,898</b>	<b>789,229</b>
Zhvlërësimi dhe amortizimi	(152,020)	(183,097)
<b>Fitim / Humbje Operative (EBIT)</b>	<b>556,879</b>	<b>606,132</b>
Shpenzime Financiare - neto	(121,388)	(230,310)
Të ardhura financiare	1,937,147	1,128,065
Shpenzime financiare	(2,058,535)	(1,358,375)
<b>Fitim nga Aktiviteti</b>	<b>435,491</b>	<b>375,823</b>
Shpenzime Tatim Fitimi	(415,952)	(268,247)
<b>Fitim / Humbja e Periudhës</b>	<b>19,539</b>	<b>107,575</b>

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me konsideratë,

**Algert LUZI**  
Administrator

**FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A.**

